

De Biasi: Per ditelindje dua fitore

nga Administrator

E premte, 17 Qershor 2016 14:24



Dje, tranjeri i kombetares shqiptare Gianni De Biasi ka mbushur 60 vjec. I gjithe stafi i Shqiperise me ne krye presidentin e federates shqiptare Armando Duka kane uruar tranjerin italian dhe kane festuar sebashku me nje torte ku ka qene i raprezentuar flamuri shqiptar. Nga ana e tij, De Biasi ka falenderuar presidentin dhe ne vecanti lojtaret e kombetares. Ai edhe njehere ka falenderuar te gjithe lojtaret per impenjimin e tyre ne ndeshjen kunder Frances si edhe nuk ka harruar te bej komplimentet atyre. De Biasi ka vene ne dukje edhe njehere forcen e lojtareve te tij, dhe i ka thene qe lojtaret duhet te kene besim tek cilesite qe kane. Gjithashtu De Biasi i ka kerkuar lojtareve qe si dhurate per ditelindje fitoren kunder ekipit te Rumanise dhe kualifikimin.

Edhe stafi i albaniasoccer.com i uron tranjerit kuqezi shume suksese ne karrieren e tij si edhe sa me shume fitore ne krye te Shqiperise.